



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT
PERMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE "ENSOLA KUÇI"

Nr.1495/Prot.

Tiranë, me dt.25/11/2020

U R D H Ë R
VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit

T I R A N Ë

Unë, përmbaruese gjyqësore private Ensola Skënder Kuçi, me Nr. certifikate 225, regjistruar në QKR me Nr. NIPT:L51801021A, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr.577/Regj, bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr.666-(446), datë; 21.07.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë,

KONSTATOVA:

Se me datë; 01.09.2020 është depozituar pranë përmbarueses gjyqësore private "Ensola Kuçi", kërkesa e kreditorit, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Korçë, së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit, lëshuar për Titullin Ekzekutiv, Vendim administrativ nr.0004382, datë 18.02.2015, me palë dhe objekt:

Kreditor : Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Korçë
Debitor : Shoqëria "Elektro Lubonja" perf. nga Agron Hasankolli
Objekti : Pagim gjobe

Zyra përmbarimore, në mbështetje të nenit 133 të K.Pr.Civile, lajmërimi për ekzekutim vullnetar është bërë me shpallje. Megjithëse pala debitore ka marrë dijeni nuk ka vepruar për shlyerjen e detyrimit sipas afatit të përcaktuar në nenin 517 të K. Pr. Civile. Gjithashtu, palës debitore i është bërë me dije se në ngarkim të saj, bazuar në nenin 30 pika 3 të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative", janë dhe kamatë vonesat në vlerën 2% në muaj të masës së gjobës, e cila përlllogaritet nga data e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit deri në përmbushjen e detyrimit nga ana e palës debitore. Për rrjedhojë, në mbështetje të nenit 519 të K. Pr. Civile, ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Sa sipër, për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv duhet të kryhet bllokimi i kuotave apo kapitalit të shoqërisë debitore.

Sa sipër, bazuar në nenin 527 e vijues të K. Pr. Civile;

U R D H Ë R O J ;

Vendosjen e masës së sekuestros mbi kuotat/kapitalet e palës debitore **Shoqëria "Elektro Lubonja" perf. nga Agron Hasankolli, me NIPT: K94003002M**, në mënyrë që të mos kryhet asnjë veprim tjetërsimi apo disponimi.

Sekuestro duhet të vendoset në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.666-(446), datë; 21.07.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, duke respektuar rradhën e preferimit, bazuar në nenin 605 të K.Civil.

Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Bashkëngjitur po ju dërgojme një kopje të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.666-(446), datë; 21.07.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

Ensola S. KUÇI



REPUBLICA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
KORÇË

Nr.Regj.Them. 447-00685
Dt.Regj. 15.07.2020

Nr. Vendimi 666(446)
Dt. Vendimi 21.07.2020

VENDIM
PËR LËSHIM URDHËR EKZEKUTIMI

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, e përbërë nga:

GJYQTAR LIGORAQ TOSHI

asistuar nga sekretare gjyqësore Viola Palla, sot, më datë 21.07.2020, ora 11.10 mori në shqyrtim, pa praninë e palëve, kërkesën administrative me nr.447-00685 regj.themeltar që i përket:

- KËRKUES:** Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Korçë.
Adresa: Rruga "1 Maji", Lagjja nr. 18, Korçë.
- OBJEKTI:** Kërkohet lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për ekzekutimin e vendimit administrativ me nr. 006055, të procesverbalit me datë 13.01.2015 dhe nr. 004382 të vendimit përfundimtar me datë 18.02.2015 të Inspektorit Shtetëror të Punës, Korçë.
- BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 9634, datë 30.10.2006 Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin e Punës, neni 34, pika 3 i ndryshuar si dhe neni 510 germa e dhe neni 511 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata, duke iu referuar përmbajtjes së kërkesës objekt gjykimi si dhe provave shkresore bashkangjitur,

VËREN

I. RRETHANA FAKTI

Pala kërkuese, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Korçë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Korçë, me kërkesë me anë të së cilës ka kërkuar: *Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për ekzekutimin e vendimit administrativ me nr. 006055, të procesverbalit me datë 13.01.2015 dhe nr. 004382 të vendimit përfundimtar me datë 18.02.2015 të Inspektorit Shtetëror të Punës, Korçë.*

Kërkuesi është organ administrativ i cili vepron sipas ligjit të posaçëm, nr.10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe Ligjit 9634, datë 30.10.2006 Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin e Punës.

Rezulton se në datë 13.01.2015, inspektorët e punës kanë ushtruar kontroll në subjekt dhe kanë përpiluar procesverbalin nr. 006055.

Bazuar në këtë procesverbal është marrë vendimi përfundimtar i inspektimit nr. 0004382, datë 18.02.2015, duke vendosur gjobë ndaj tij gjithsej në masën 660.000 lekë.

Duke pasur parasysh se kundërvajtësi ka ushtruar ankim dhe me vendimin nr. 471/2 prot, datë 03.04.2015 të Komisionit të Ankimit të Gjobave të ISHPSHSH është lënë në fuqi vendimi përkatës. Gjithashtu kundërvajtësi i është drejtuar Gjykatës e cila me vendimin nr. 421, datë 11.09.2015 ka vendosur rrëzimin e padisë për shfuqizimin e vendimit të ISHPSHSH Korçë dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë.

Në këto kushte, kërkuesi kërkon të lëshohet urdhëri i ekzekutimit për të vijuar me procedurat e ekzekutimit, arsye për të cilën i është drejtuar Gjykatës me kërkesën objekt shqyrtimi.

II. VLERËSIMI I GJYKATËS.

Gjykata, përpara se të marrë në shqyrtim kërkesën administrative, konstaton se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe në kompetencën lëndore dhe tokësore të kësaj Gjykate, bazuar në nenin 1, pika 2 të ligjit organik nr. 49/2012, "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar, si dhe në nenet 510 dhe 511 të K.Pr.Civile.

Sipas përcaktimit të nenit 511 të K.Pr.Civile paragrafi i tretë, shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit zhvillohet nga gjyqtari *pa praninë e palëve*.

Kërkuesi, është ngarkuar me detyrat e inspektimit dhe sipas nenit 33 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 *Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin e Punës*, parashikohet e drejta për vendosjen e gjobës, konkretisht *për rastet e shkeljes së legjislacionit të punës, inspektori i punës vendos gjobë (...)*. Për pasojë, ai *legjitimohet në depozitimin e kësaj kërkesë administrative*.

Gjithashtu, sipas nenit 510, gërma e) të K.Pr.Civile, konsiderohen tituj ekzekutivë "*aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre*".

Për të përcaktuar nëse vendimi objekt shqyrtimi përbën titull ekzekutiv duhet t'iu referohemi dispozitave të nenit 20 dhe 22 të ligjit nr. 10279, datë 20.02.2010, "*Për kundërvajtjet administrative*", i ndryshuar.

Sipas nenit 22 rezulton se "*1. Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji*". ndërkohë që sipas nenit 20, përcaktohet se "*Objekt i këtij kreu janë vendimet për kundërvajtjet administrative, që parashikojnë dënime me gjobë, të vendosura nga: ... a) institucionet e organizuara si inspektorate shtetërore, pavarësisht nga mënyra e organizimit të tyre dhe nga objekti i veprimtarisë*;

Nëse i referohemi ligjit të posaçëm, nr. 9634, datë 30.10.2006 *Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin e Punës*, parashikohet se 3. *Kur vendimi i inspektorit të punës për detyrimin e pagesës së gjobës merr formë të prerë, ai është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit*. Pra, rezulton se vendimi objekt shqyrtimi, në kushtet kur është ankimuar dhe është vendosur lënia në fuqi e tij ka marrë formë të prerë, pra rezulton titull ekzekutiv.

Pasur parasysh sa më sipër, në kushtet kur kërkuesi ka vepruar si inspektoriat shtetëror dhe ka konstatuar kryerjen e një kundërvajtje e cila është e parashikuar si e tillë nga ligji i posaçëm që rregullon veprimtarinë në fushën e punës, vendimi objekt shqyrtimi **rezulton titull ekzekutiv**.

Nga ana tjetër, Kodi i Procedurës Civile, në nenin 511 përcakton se: *Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit, bazuar mbi dokumentet e depozituara nga kërkuesi.*

Urdhri i ekzekutimit përmban:

a) gjeneralitetet e debitorit dhe kreditorit;

b) origjinën e detyrimit;

c) detyrimin konkret që buron nga titulli ekzekutiv deri në momentin e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit;

Neni 513 i K.Pr.Civile parashikon se *Urdhri i ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje.*

Duke iu referuar vendimit përkatës dhe provave bashkëngjitur rezulton se subjekti kundërvajtës është identifikuar si subjekti Elektro Lubonja SHPK, me përfaqësues Agron Hasankolli, dhe vendimi përkatës është ankimuar prej tij, pra konkludohet se subjekti ka dijeni për vendimin.

Gjithashtu, detyrimi rezulton nga kryerja e kundërvajtjes dhe është i përcaktuar saktë, si gjobë gjithsej në vlerën 660.000 (gjashtëqindgjashtëdhjetë mijë) lekë.

Pasur parasysh sa më sipër dhe referuar kundërvajtjes së konstatuar, Gjykata vlerëson se nga ana formale vendimi përkatës është marrë nga organi i autorizuar nga ligji dhe është identifikuar në mënyrë të saktë subjekti kundërvajtës dhe detyrimi përkatës, i cili rezulton i saktë dhe i pakushtëzuar, duke marrë dijeni për të, arsye për të cilën konkludon se ka vend për pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

III. SHPENZIMET GJYQËSORE

Referuar shpenzimeve gjyqësore, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ka vend për disponim për to, për sa kohë që kërkuesi paraqitet si subjekt shtetëror, i cili, përjashtohet nga pagesa e tarifës gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 9, të ligjit nr. 98/2017 *Për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë*, ku sanksionohet se *2. Çdo organ publik buxhetor që kryen funksione administrative, gjykatat ose prokuroria, përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore, përveç rasteve kur humbasin çështjen gjyqësore dhe ligji procedural parashikon detyrimin e tyre për paguar shpenzimet e palës tjetër.*

IV. E DREJTA E ANKIMIT.

Për sa i përket të drejtës së ankimit, Gjykata vëren se Kodi i Procedurës Civile, në nenin 512 *Ankimi për mosdhënie të urdhrit të ekzekutimit*, parashikon se *Kundër vendimit me të cilin refuzohet dhënia e urdhrit të ekzekutimit, mund të bëhet ankim sipas rregullave mbi ankimet e veçanta.*

Në rastin konkret, duke interpretuar në të kundërt (*per a contrario*), në kushtet kur kërkesa administrative për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit u pranua dhe ligjvënësi nuk ka parashikuar të drejtë ankimi, ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim.

Sa më sipër, Gjykata, vlerëson se kërkesa i plotëson kriteret ligjore dhe, për pasojë, duhet pranuar

PËR KËTO ARSYE

bazuar në nenin 510, gërma e) dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr 0004382, datë 18.02.2015, të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Korçë, për subjektin ELEKTRO LUBONJA SHPK me përfaqësues Agron Hasankolli, për detyrimin gjorbë në masën 660.000 (gjashtëqindegjashtëdhjetëmijë) lekë.
3. Për ekzekutimin e këtij urdhëri ngarkohet shërbimi përmbarimor, shtetëror ose privat.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.
5. Ky urdhër lëshohet në një kopje.
6. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

U shpall në Korçë, më datë 21.07.2020.

SEKRETARE GJYQËSORE
VIOLA PALLA



GJYQTAR
LIGORAQ TOSHI

